





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



TV DIELLI
Zamir QERIQI
Drejtor
Prishtinë

VENDIM

**Lidhur me Rastin Nr. 2019/99– Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për TV DIELLI
("Pala Përgjegjëse")**

Faktet

1. Pala Përgjegjëse është pajisur me Licencë të KPM-së me datën 9 mars 2016. Pranimi dhe nënshkrimi i Licencës obligon të Licencuarin që të veprojë në përputhje me Ligjin e KPM-së dhe me të gjitha aktet tjera përkatëse ligjore.
2. Në bazë të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, KPM është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave përmes të cilave përcaktohet sjellja e mediave gjatë fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore.
3. KPM, e ka përcjell pajtueshmërinë e Palës Përgjegjëse me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073, gjatë mbulimit të fushatës zgjedhore të subjekteve politike lidhur me mbajtjen e Zgjedhjeve të Përgjithshme në Republikën e Kosovës gjatë vitit 2019.
4. KPM, me qëllim të sigurimit të zbatimit të Ligjit nga ana e Palës Përgjegjëse para fillimit të fushatave zgjedhore, me datën 19 shtator 2019, përmes e-mail-it ia ka dërguar Palës Përgjegjëse Ditarët A dhe B (për terminët e reklamave të emetuara pa pagesë dhe me pagesë) duke ia sqaruar edhe mënyrën e plotësimit të tyre.
5. KPM, nëpërmes një shkrese me datën 6 nëntor 2019, ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që t'i sjell ditarët A dhe B dhe ka udhëzuar që të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, në të kundërtën Komisioni i KPM-së do të marr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
6. Pala Përgjegjëse edhe përkundër kërkesave dhe njoftimeve të KPM-së ka dështuar t'i dorëzojë në KPM Ditarët A dhe B.

Analiza Ligjore

7. Komisioni, bazuar në faktet dhe analizat e lartpërmendura, konstaton se Pala Përgjegjëse gjatë zgjedhjeve të vitit 2019 në Republikën e Kosovës, ka dështuar t'i sjellë Ditarët A dhe B, duke vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili përcakton se:

”Nga transmetuesit kërkohet të mbajnë ditarë të veçantë ditorë, të siguruar nga KPM-ja për qasjet e siguruar pa pagesë dhe kohët për reklamim që i janë shitur çdo subjekti politik të certifikuar. Këta ditarë përgatiten dhe i dorëzohen KPM-së për çdo javë në përputhje me udhëzimet e dhëna. Pasi të merren, ditarët janë të hapur për t’u shikuar nga publiku”.

8. Komisioni konstaton se Pala Përgjegjëse edhe pas shkresave me udhëzime e sqarime se si të plotësohen Ditarët A dhe B, dhe pas shkresave paralajmëruese për t’i sjellë ditarët menjëherë, ka dështuar që të marrë hapa të nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me Kreun VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme.
9. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse në mënyrë të vazhdueshme ka vepruar në kundërshtim me nenin 49, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Vendimi

10. Komisioni bazuar në nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, sanksionon Palën Përgjegjëse me **Vërejtje** për shkelje të neni 49, paragrafi 7, të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.
11. Obligohet Pala Përgjegjëse, që në të ardhmen të veprojë në pajtim me nenin 49, paragrafi 7, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, duke i sjellë ditarët ashtu siç kërkohet me nenin 49, paragrafi 7, të Ligjit për Zgjedhjet Nr. 03/L-073.
12. Dështimi i Palës Përgjegjëse që edhe pas pranimit të këtij Vendimi të dorëzojë ditarët për Zgjedhjet e ardhshme, me automatizëm do të rezultojë më masa tjera me të ashpra ligjore sipas nenit 30 të Ligjit të KPM-së.

E drejta për Ankesë

13. Ankesat i parashtrihen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
14. Bordi për Ankesa do t’i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërisht relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Muja FERATI
Kryetar



02. 03. 2020
Datë